

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa asnjë diskutim ne nuk mund t'i shmangemi dhe nuk mund të sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë lidhur me konstatimet më të fundit që vijnë nga raporti i DASH-it. Ne dëgjuam se Kryeministri e konsideroi këtë thjesht dhe vetëm një kopje të raportit të një viti më parë. Pra, kur raporti është qartësisht ballor dhe pa asnjë ekuivok, Edi Rama e quan kopje, por kur raportet i pëlqejnë janë shumë të rëndësishme. Në prill të vitit 2016 Edi Rama jepte disa konsiderata në atë kohë për raportin i DASH-it dhe thoshte: "Raporti më pozitiv i DASH-it në 25 vjet për arritjet e vendit, inkurajim për më tutje në drejtimin e duhur". Pra, di ta vlerësojë raportin e DASH-it kur i pëlqen, kur nuk i pëlqen është kopje. Po pse nuk i pëlqen Edi Ramës ky raport? Nuk i pëlqen, sepse është një dëshmi e destrukturimit të plotë shtetëror, e tronditjes, e krisjes dhe e thyerjes së shtyllave të shtetit dhe kthimit të shtetit në një çetë grabitqarësh, gjithashtu, sepse zë pas zëri në raport jepet opinioni për zgjedhjet dhe citohet fare qartë raporti i OSBE-ODIHR-it, ku evidentohen rrjedhja e të dhënave personale dhe avantazhi i konsiderueshëm i fituar nga partia në pushtet për shkak të të qenit në pushtet. Këtë e thotë raporti i DASH-it, ku evidentohet institucioni i votës i rrënuar, themeli që ndërton këtë sallë, që ndërton institucionet.

Vijmë te drejtësia, për të cilën është shumë zhurmë e madhe. E kam thënë shpesh "dashnorët e drejtësisë" këtu, kur janë shfaqur vazhdimisht për propagandë, por e vërteta cila është? Raporti thotë se, megjithëse Kushtetuta parashikon gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi dhe korrupsioni e penguan gjyqësorin të funksionojë në rrugë të pavarur dhe efikase. Këto i thotë raporti, megjithëse edhe opozita i ka thënë shpesh, por tani po i gjejmë të thëna nga partneri më i madh strategjik. I keni përdorur dhe shpërdorur sa ia keni nxjerrë bojën kësaj pune, por ne po citojmë fjalët e tyre. Më tutje në raportin e DASH-it thuhet: "Portretizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese herë pas here kërcënoi të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve". Më tutje thuhet se individë dhe organizata kërkojnë instrumente juridike për shkeljen e të drejtave të njeriut. Janë raportuar raste të korrupsionit gjyqësor, të frikësimit dhe ndërhyrjes politike.

Kjo është drejtësia e re pas 6 vjetësh, një drejtësi, e cila është e kolapsuar, e kapur, e politizuar, jocilësore, se është e mbingarkuar aq sa edhe në raportin e DASH-i thuhet që vetëm në Gjykatën e Lartë janë 36 mijë dosje. Kjo është drejtësi që funksion me dy standarde, përfshirë edhe të famshmin veting. Natyrisht, si e tillë, nga iluzion shprese i ngritur dikur, është kthyer në zhgënjim për qytetarët dhe ka siguruar vetëm atë që raporti e citon sërish "pandëshkueshmërinë e qeveritarëve". Po në këtë raport thuhet se drejtësia ka dështuar të ecë në drejtim të ndëshkimit të zyrtarëve të lartë. Gjithashtu, në raport thuhet se shtylla tjetër e shtetit, qeveria, pushteti ekzekutiv, ka thellim galopant të korrupsionit, i përhapur në të gjitha degët e qeverisjes, në të gjithë zyrtarët qendrorë dhe lokalë. Pra qartazi, edhe ky

pushtet është i rënë, pasi edhe pushteti në këtë sallë është fiktiv dhe vepron në kufijtë e urdhrin politik me fuqinë e shumicës së votës.

Pra, as argumenti, as emergjencat, as logjika, as e mira e qytetarëve nuk mbizotëron, por mbizotëron rreshti politik kundër arsyes dhe së mirës, përfshirë edhe çështje shumë sensitive si kjo që kemi përjetuar dhe po përjetojmë me problemin shumë kritik të çmimeve. Vazhdojmë më tej, brenda pushtetit ekzekutiv. Çfarë thuhet për policinë në raportin e DASH-it? Atë që ne e kemi ngritur shpesh personalisht, madje i jam drejtuar prokurorisë që të hetojë për sjelljen arbitrare, të dhunshme dhe të paligjshme të policisë. Raporti thotë se policia nuk e ka zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë. "Lidhjet personale politike, kriminale, mungesa e pajisjeve, mbikëqyrja e pamjaftueshme shpesh patën pasoja në zbatimin e ligjit"- thuhet në raport. Çfarë policie është kjo, pra? Polici politike shumë e dhunshme me protestuesit dhe qytetarët e ndershëm, e maskuar dhe pamaskuar dhe një polici që nuk bën asgjë përveç se siguron prapavijat e krimit dhe trafikantëve.

Dje, drejtori i çështjeve ndërkombëtare të narkotikëve dhe zbatimit të ligjeve në ambasadën amerikane, Benxhamin Rokuell tha se qenia e Shqipërisë në listën gri për pastrimin e parave është një shenjë turpi për vendin. Nuk e thotë opozita, e thonë amerikanët që i keni merak t'i dëgjoni. Gjithashtu, ai thotë se vendosja në listën gri është pengesë për investimet ndërkombëtare dhe për rritjen ekonomike. Kur ka një ndikim kaq të madh në shoqëri, është problem i madh shoqëror. Dhe duke përfunduar zyrtari amerikan thotë se nuk ka nevojë për shumë ekspertizë për të parë rreth qytetit, në bregdet apo kudo ku shihet prezenca e pasurive të paligjshme në sistemin shqiptar. Ky është shteti i destruktuar, shtet, që është zëvendësuar me një çetë grabitqarësh, dhe që duke qenë në këtë situatë kaq të rëndë ka zgjedhur dy rrugë për të dalë nga situata: të legalizojë kanabisin dhe të amnistojë paratë. Legalizimi i kanabisit është thjesht noterizimi i pushtimit me kanabis të Shqipërisë dhe kriminalizmi përfundimtar i vendit, duke zëvendësuar bujqësinë, energjinë, zhvillimin ekonomik dhe mjaft fusha të tjera ku duhej të zhvillohej punësimi, në mënyrë të veçantë për të rinjtë, me ekonominë e falimentuar të kanabisit, dhuratë për trafikantët për një kohë të caktuar, sa miliardat e tyre të jenë ngopur plotësisht. Dhe më pas vjen amnistia.

Dëgjuam që amnistinë do ta bëjnë patjetër, sepse paska shumë para të këtyre që robtohen dhe punojnë në Greqi ose gjetkë, që mbledhin ulla ose punojnë në ndërtim dhe që qenkan bërë miliardë dhe t'iu krijojmë mundësi që këto para t'i fusin në sistem. Por, në fakt, është e kundërta. Si është e kundërta? Po ju përgjigjem jo me fjalët e mia, sepse e di që nuk do t'i zërë turpi këta, por çfarë thotë FMN-ja për këtë gjë. Këta janë fanar, në fakt, dhe nuk iu duhet FMN-ja. Pra, sipas FMNsë amnistia ul të ardhurat, sjell pastrim parash dhe korrupsion. FMN-ja nuk është opozitë, por është institucioni, i cili na ka asistuar dhe na asiston, por gjithashtu FMN-ja është një kritikë e paanshme, profesionale dhe me peshë të madhe në politikën financiare botërore. Këto janë konsiderata të mëdha, kjo është rruga, por qorrsokaku na ka çuar në destruktivitet të shtetit dhe kthim në çetë grabitqarësh.

Kështu që është shumë e qartë se këto lloj raportesh që janë një skaner i vërtetë i kriminalizmit të qeverisjes, janë kopje për Kryeministrin, por, ama, njëherazi janë e vërteta shumë e hidhur dhe shumë e rëndë për shqiptarët. Kjo qeveri njihet mirë edhe përtej Atlantikut, por këtu bën demagogji dhe propagandë. Kjo qeveri po e shpopullon vendin dhe po i detyron mijëra shqiptarë të largohen nga ky

vend kaq i mirë dhe i bekuar vetëm se është kapur për fyti nga një grup njerëzish që të pangopur duan t'i nxjerrin themelin. Këto janë të vërteta, të cilat nuk ka asnjë propagandë që i fsheh dot.